




KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

MANUAL PRAKTIK

*Rritja e aksesit në gjykimin kushtetues
të Organizatave të Shoqërisë Civile*

Qershor, 2018





MANUAL PRAKTIK

**Rritja e aksesit në gjykimin
kushtetues të Organizatave të
Shoqërisë Civile**

Qershor, 2018



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
16. Çfarë kushtesh dhe kriteresh formale duhet të plotësohen nëpërmjet kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese?	17
18. A ka tarifë gjyqësore për akses në gjykimin kushtetues?	19
19. A është e domosdoshme të mbrohesh me avokat në gjykimin kushtetues?	19
20. Sa kohë kanë OJF-të në dispozicion, për t'iu drejtuar Gjykatës nga marrja dijeni për shkeljen e pretenduar?	19
22. Si është procedura e shqyrtimit paraprak në Kolegje/Mbledhjen e Gjyqtarëve?	20
23. A mund të kërkohej pezullimi ligjit/aktit nënligjor apo vendimit gjyqësor?	21
25. Si realizohet komunikimi mes OJF-ve dhe Gjykatës, kur çështja pranohet për shqyrtim prej saj? ..	22
26. Çfarë të drejtash kanë OJF- të gjatë gjykimit kushtetues si palë në proces?	22
27. A mundet OJF - të, t'i kërkojnë Gjykatës opinion këshillimor nga GJEDNJ?	23
28. Sa zgjat procesi gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese?	23
Vendimi jepet nga Kolegji, i përbërë nga 3 gjyqtarë, ose Mbledhja e Gjyqtarëve e përbërë nga 6 deri 9 gjyqtarë, mbi kalimin ose mos kalimin në seancë plenare. Vendimi përfundimtar jepet nga Gjykata pas shqyrtimit në seancë gjyqësore të kërkesës, e cila vendos mbi themelin e kërkesës.	24
32. Si bëhet shpallja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese?	24
33. Cilat janë efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese?	24
IV. DISA PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	27
V. BURIME REFERUESE DHE SHTOJCA	29
A. Ekstrakt i Kushtetutës	29
B. Ekstrakt i Ligjit Organik të GJK	30
C. Jurisprudencë e GJK me subjekt kërkuar "organizatat"	32

Ky manual është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XII”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Përmbajtja e këtij manuali është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders

Punoi:

Znj. Elsa Dobjani, Eksperte Ligjore

Rishikoi:

Z. Niazi Jaho – Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit,

Znj. Erida Skëndaj – Drejtoreshë Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor:

©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati “Tekno Projekt”

Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Cel: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

PARATHËNIE

Roli i shoqërisë civile në një demokraci kushtetuese, është i rëndësishëm. Organizatat e shoqërisë civile janë ndoshta nga aktorët më të interesuar për të aksesuar gjykimin kushtetues. Ato, (*watchdog organizations*) konsiderohen si "rojtare" të vlerave dhe parimeve kushtetuese, pasi me rolin e tyre ndihmojnë në zbatimin dhe respektimin e këtyre vlerave dhe parimeve, sipas standardeve të kërkuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Me ndryshimet kushtetuese të fundit, në kuadër të Reformës në Drejtësi, (korrik 2016), dhe ndryshimet e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese mori jetë dhe ideja e botimit të këtij manuali praktik për orientimin dhe edukimin e anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile (më poshtë "OJF", ose "organizatat") me rritjen e aksesit në gjykimin kushtetues.

Gjykata Kushtetuese (në vijim "Gjykata", ose "GJK") ka një jurisprudencë mbi 26 -vjeçare, tashmë të mjaftueshme për orientim mbi standardet e drejtësisë kushtetuese. Ky botim do të prezantojë vetëm ato detyrime kushtetuese dhe ligjore si dhe ato vendime, që i interesojnë dhe mund t'i interesojnë potencialisht organizatave të shoqërisë civile, me fokus veprimtarie mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut si dhe përmirësimin e legjislacionit në këtë drejtim.

Qëllimi i këtij manuali, është që t'i vijë në ndihmë organizatave, që e kanë fituar personalitetin juridik përmes ligjit nr.8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", dhe që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për mbrojtjen e interesave të tyre, sipas misionit apo veprimtarisë që ushtrojnë, apo sipas interesave të anëtarësisë. Këto organizata jo-fitimprurëse e zhvillojnë veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti, dhe ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut.

Sigurisht, manuali mund të vlejë si udhëzues praktik për këdo të interesuar, sidomos për avokatë që ndjekin çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, si edhe për shoqata apo organizata të tjera, të cilat mund ta kenë fituar personalitetin juridik, jo sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse, por që sipas nenit 134/1/h të Kushtetutës, mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për mbrojtjen e interesave të anëtarësisë së tyre apo mbrojtjen e interesave sipas misionit, veprimtarisë që ushtrojnë të tilla si; organizatat e karakterit ekonomik, tregtar, politik, kulturor, etj.

Manuali është një udhërrëfyes i thjeshtë për aq sa mund të arrihet që kontrollin kushtetues, si një fushë me teknikalitet tepër të lartë, ta shpjegosh me një gjuhë të thjeshtë, për grupet e interesit, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të cilët mund dhe duhet të aksesojnë gjykimin kushtetues për të realizuar të drejtat e individit.

Manuali me një gjuhë të kuptueshme, synon të informojë OJF-të mbi metodologjitë procedurale dhe substanciale më të përshtatshme për kontrollin kushtetues të akteve normative ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të pushtetit publik si vendimet gjyqësore, nëpërmjet ankimit individual, dhe t'i edukojë ata me standardet e kërkuara në këtë drejtim.

Synimi kryesor mbetet që grupet e interesit, të marrin dijeni për mënyrat, mjetet dhe instrumentet, që mund të përdorin për të aksesuar kontrollin kushtetues, për më tepër që ndryshimet e ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, në nëntor 2016, kanë sjellë zgjerim të juridiksionit kushtetues.

Konkretisht, nëpërmjet këtij manuali synohet:

- edukim dhe ndërgjegjësim i grupeve të interesit me aksesin dhe gjykimin kushtetues;
- përmirësim i kapaciteteve të organizatave, shoqatave, me aksesin në gjykimin kushtetues dhe të drejtat kushtetuese të grupeve vulnerabël;
- Rritja e rolit dhe e rëndësisë së organizatave në gjykimin kushtetues, në përputhje me misionin e tyre.
- menaxhim më i mirë i interesave të tyre të ligjshme, në varësi të qasjes kushtetuese, si strategji mbrojtëse e përzgjedhur për efikasitet më të lartë.

Ky manual ka parashikime dhe informacion për të dyja format e kërtimeve të OJF-ve para Gjykatës Kushtetuese, edhe kriteret dhe kushtet ligjore që duhet të plotësojë një OJF, që vepron në fushën e të drejtave të njeriut, si subjekt i legjitimuar për kontroll të akteve normative ligjore dhe nënligjore, parashikuar nga neni 131/a/c dhe neni 134/1/h i Kushtetutës, edhe si subjekt i legjitimuar si përfaqësues i një viktime/ankuesi në proces gjyqësor, për ushtrimin e ankimit individual kushtetues, sipas nenit 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Gjithashtu, ky manual ka informacion për rolin *amicus curia* të OJF-ve, ose ndërhyrjen në procesin gjyqësor kushtetues, si *palë e interesuar*, rolin, funksionet dhe dallimet mes këtyre dy pozicioneve procedurale.

I. TË PËRGJITHSHME

1. Kur është miratuar Kushtetuta dhe a ka ndryshuar ajo?

Kushtetuta është miratuar nga Kuvendi në 1998 dhe u vendos përmes referendumit popullor. Disa nga dispozitat e saj kanë ndryshuar ndër vite, (2007, 2008, 2012, 2015) ndërkohë ndryshimi i fundit është realizuar në korrik 2016, me ligjin amendues nr.76/2016. Me këtë ligj janë bërë ndryshimet më rrënjësore që nga miratimi i Kushtetutës, pasi janë reformuar të gjitha organet e sistemit të drejtësisë, duke ndryshuar mënyrën e formimit, funksionimit, zgjedhjes, si dhe krijimit edhe të institucioneve të reja kushtetuese.

2. Çfarë është Gjykata Kushtetuese?

Gjykata Kushtetuese është institucion i pavarur (gjyqësor), i parashikuar nga Kushtetuta, jashtë sistemit gjyqësor tradicional i përbërë nga tre shkallë gjykimi. Ajo zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Ajo ka mision dhe funksion kryesor mbrojtjen e Kushtetutës nga cënimet e mundshme të pushtetit shtetëror dhe realizimin e drejtësisë kushtetuese.

3. Si është përbërja e Gjykatës Kushtetuese?

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.

4. Çfarë është kontrolli kushtetues?

Kontrolli kushtetues, është kontrolli që realizohet nga Gjykata Kushtetuese, ndaj akteve të nxjerra nga organet e pushtetit publik, duke u përqendruar në aspektin e pajtueshmërisë së tyre me dispozitat kushtetuese. Koncepti i juridiksionit kushtetues tregon kategorinë e çështjeve që mund të bëhen objekt shqyrtimi në gjykatën që jep drejtësi kushtetuese.

5. Cilat të drejta mbrohen gjatë kontrollit kushtetues?

Të gjitha të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, mund të mbrohen në Gjykatë Kushtetuese, përmes kontrollit kushtetues.

Konkretisht, Kushtetuta në kreun e dytë ka sanksionuar *liritë dhe të drejtat vetjake* si; e drejta për jetën, liria e shprehjes, e drejta e informimit, liria e ndërgjegjes dhe e fesë, mostrajtimi në mënyrë mizore dhe poshtëruese, mos heqja e lirisë në kundërshtim me ligjin, mos akuzimi pa të drejtë, mos dënimi fajtor për një vepër penale, e cila nuk ishte e tillë në kohën e kryerjes,

fshehtësia e korrespondencës, paprekshmëria e banesës, e drejta e lëvizjes lirisht, e drejta e pronës, etj.

Më pas, Kushtetuta vazhdon me *të drejtat e karakterit procedural* si; e drejta për një proces të rregullt ligjor, e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, etj. Ndërkohë në kreun e tretë janë parashikuar *liritë dhe të drejtat politike*; si e drejta e votës, e drejta për të organizuar kolektivisht, e drejta e anëtarësimit në shoqata, e drejta e protestës, e drejta e ankimit ndaj organeve publike, etj.

Në kreun e katërt, Kushtetuta ka parashikuar *të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*, si; e drejta për punë, e drejta për anëtarësim në sindikata, e drejta për mbrojtje shoqërore të punës, e drejta për grevë që ka lidhje me marrëdhëniet e punës, e drejta për jetë familjare, e drejta për mbrojtje të veçantë të fëmijëve, grave shtatzëna dhe nënave të reja, e drejta për kujdes shëndetësor, e drejta për arsimim dhe e drejta për krijim artistik dhe kërkim shkencor.

6. Çfarë ndryshimesh kanë sjellë normat kushtetuese dhe ligjore për aksesin kushtetues?

Statusi kushtetues i organizatave, dhe legjitimimi i tyre për kontroll kushtetues të akteve ligjore dhe nënligjore, ka qenë i parashikuar në Kushtetutë dhe posaçërisht në nenin 134/1/f, ku i jepej e drejta për të vënë në lëvizje me kërkesë Gjykatën Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e tyre. Ky mekanizëm është konsideruar si mjaft efikas dhe real, me qëllim realizimin e qëllimit të atyre organizatave, që janë krijuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nga ana tjetër, OJF- të mund t'i drejtoheshin Gjykatës, për proces të parregullt ligjor procedural, duke përfaqësuar në gjykatë të drejtat procedurale kushtetuese të viktimës, sipas nenit 131/1/f të Kushtetutës.

Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore kanë sjellë një sërë risish, si në drejtim të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, të subjekteve që legjitimohen, kushteve dhe kriterëve, procedurave dhe afateve ligjore për t'u respektuar dhe plotësuar, me qëllim të një aksesimi më të madh, qasjeje sa më cilësore të subjekteve kërkuar ndaj gjykimit kushtetues, dhe për më shumë efektivitet të vetë Gjykatës Kushtetuese, si mjet ankimi kombëtar¹.

Për më tepër, Kushtetuta ka sjellë ndryshim cilësor për ankimin kushtetues individual, nëpërmjet të cilit para kësaj gjykate kërkohet kontroll jo vetëm i procesit të rregullt ligjor procedural, kompetencë kushtetuese e konsoliduar, por edhe të çdo të drejte dhe lirie themelore të parashikuar në Kushtetutë. Po nëpërmjet ankimit kushtetues individual, individ, kur është bartës i të drejtave themelore, mund të kundërshtojë aktet ligjore dhe nënligjore normative, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

¹ Ligji amendues i Kushtetutës nr.76/2016, si dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar me ligjin nr.99/2016.

Këto ndryshime kushtetuese, sjellin një cilësi më të lartë mbrojtjeje kushtetuese për të gjithë subjektet që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe për OJF-të. Nga pikëpamja krahasimore, para dhe pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, legjitimimi i organizatave në vetvete nuk ka ndryshuar, por hapësirat e tyre dhe format për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese janë shtuar, pasi mund të ushtrojnë më tepër mbrojtje për viktimat që pretendojnë shkelje të të drejtave themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutë, përmes ankimit kushtetues individual, si dhe mund të rrisin bashkëveprimin e tyre me subjekte të legjitimuara për herë të parë në gjykim kushtetues si komisionerët, ose me Avokatin e Popullit si subjekt që nuk është i detyruar të provojë interesin, për të pasur sukses në mbrojtjen e çështjeve me objekt kundërshtimin e akteve ligjore dhe nënligjore si antikushtetuese.

II. MBI AKSESIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

7. Për çfarë mund t'i drejtohen OJF-të, Gjykatës Kushtetuese?

- Organizatat mund të venë në lëvizje Gjykatën për kontrollin konkret të akteve ligjore/nënligjore, për çështje që kanë lidhje me interesat e tyre.
- Organizatat mund të përfaqësojnë një individ para Gjykatës Kushtetuese, të cilin e kanë mbrojtur ose jo edhe tek tre shkallët gjyqësore të ankimit dhe të ushtrojnë ankim kushtetues individual para Gjykatës, për shkelje të çdo të drejte dhe lirie të parashikuar në Kushtetutë ndaj viktimës. Në këtë pozitë procedurale, OJF -të kanë të njëjtin rol si dhe në kërkesat që i drejtojnë GJEDNJ, për përfaqësim të një pale të dëmtuar².

8. Cilat janë mënyrat se si mund t'i drejtohen OJF -të, Gjykatës?

Gjykatës mund t'i drejtohesh me kërkesë, nëpërmjet postës, ose nëpërmjet dorëzimit të kërkesës dorazi pranë Drejtorisë Gjyqësore të kësaj gjykate. Në rast të dërgimit të kërkesës me postë, data e paraqitjes së saj konsiderohet data e dorëzimit në zyrën postare.

9. Cilat janë kriteret e legjitimitimit për OJF-të, në rastin e kontrollit konkret të akteve normative?

²Neni 34 i KEDNJ, nën titullin “Kërkesat individuale”, parashikon se gjykata mund të marrë kërkesa nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh, të cilët pretendojnë të jenë viktimat të një shkeljeje të bërë nga një prej palëve të larta kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Organizata mund të luajë një rol aktiv nëpërmjet mbrojtjes të të drejtave të aplikantit/aplikantes. Një OJF mund të përfaqësojë interesat e viktimës, ose mund të ndërhyjë në proces si palë e tretë duke dhënë komente me shkrim, ose duke marrë pjesë në proces gjyqësor.

OJF -ja, si subjekt kërkues duhet të provojë se ka personalitet juridik, nëpërmjet vendimit të regjistrimit në gjykatë, se e ka brenda misionit apo veprimtarisë së vet të drejtën që kërkon të mbrojtë dhe se dispozita ligjore/ nënligjore e kundërshtuar cenon të drejtën përkatëse, duke sjellë pasoja reale negative, si dhe që është brenda afatit ligjor për paraqitjen e kërkesës.

9.1. Si provohet interesi vetjak i OJF-së, në rastin e kontrollit konkret të akteve normative?

Që të provojë që ka interes për çështjen që ka vënë në lëvizje, një organizatë duhet:

- të saktësojë se në çfarë cilësie vepron kundër dispozitës së kundërshtuar;
- të argumentojë lidhjen mes misionit për të cilin është krijuar, apo veprimtarisë që kryen me dispozitën e kundërshtuar për antikushtetutshmëri;
- të vërtetojë se në çfarë mënyre mund të preket në një aspekt të çfarëdoshëm të situatës së tij/saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar, që ekziston midis situatës së tij/saj dhe normës që kundërshton.
- të vërtetojë se çfarë dëmi apo pasoje antikushtetuese, mund të vijë nga zbatimi i dispozitës konkrete.

Shembull: Një shoqatë që është krijuar me anëtarësi dhe ka si mision mbrojtjen e të drejtës së pronës, i drejtohet gjykatës për disa norma të Ligjit mbi zhvillimin e turizmit, pasi sipas saj, shpronësimi i pronarit në truall turistik për interes publik, është antikushtetues.

Gjykata nuk e legjitimoi, pasi sipas saj, shoqata nuk argumenton që ky ligj ka cënuar interesat e krijimit dhe veprimtarisë së saj dhe nuk argumenton lidhjen e drejtpërdrejtë midis qëllimit për të cilin është krijuar apo veprimtarisë që ajo kryen dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, të cilat kërkohen të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën.³

9.2 A ka rëndësi periudha apo koha kur është regjistruar OJF-ja, për efekt legjitimitimi?

Koha se kur është regjistruar shoqata, dhe jo koha kur është krijuar, merret në konsideratë për të vendosur mbi legjitimitimin.

Gjykata i ka dhënë përgjigje lidhjes mes kohës së regjistrimit dhe legjitimitit, ku u shpreh se: "...kërkuesja është një organizatë jofitimprurëse, e regjistruar si shoqatë në datën 09.10.2017 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa kërkuesja e ka paraqitur kërkesën para Gjykatës në datën 06.10.2017, kështu që në rastin konkret kërkuesja nuk legjitimohej, pasi në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk gëzonte personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit"⁴.

³Vendim nr. 13 datë 24.01.2018 i Mbledhjes së Gjyqtarëve (mos kalimi në seancë); Vendim nr. 14 datë 24.01.2018 i Mbledhjes së Gjyqtarëve (mos kalimi në seancë)

⁴Vendim i Mbledhjes së Gjyqtarëve nr.28 datë 08.02.2018 (mos kalimi në seancë)

9.3 A ka rëndësi veprimtaria faktike për efekt legjitimimi?

Veprimtaria faktike e organizatës, nëse do i drejtohej Gjykatës Kushtetuese një organizatë e krijuar pas hyrjes në fuqi të ligjit objekt kundërshtimi në gjykatë, dhe që presupozohet se nuk ka kryer veprimtari faktike në përputhje me misionin e saj, mund të sillte debate mbi legjitimimin. Pra situata, kur një OJF- është krijuar pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe ka fituar personalitet juridik, por veprimi i parë që kryen pas krijimit, mund të jetë kërkesa në Gjykatë Kushtetuese. Në këtë rast, do të ishte e këshillueshme, bashkëveprimi me shoqata aktive të fushës, me veprimtari të konsoliduar për të mos krijuar probleme me legjitimimin.

9.4 A ka rëndësi natyra e pretendimeve të paraqitura para Gjykatës?

Natyra e pretendimeve ka rëndësi për kontrollin konkret të ligjeve apo akteve nënligjore, kur procesi inicohet nga OJF- të. Ato nuk legjitimohen për pretendime si; mosrespektimi i hierarkisë së akteve, procedura e ndjekur për miratimin e ligjit, shumica e kërkuar, e të tjera të ashtuquajtura kriteret formale kushtetuese. OJF duhet të pretendojë shkelje të të drejtave të njeriut, dhe vetëm pasi Gjykata i gjen të bazuara këtë lloj pretendimesh substanciale, ajo mund të kontrollojë dhe aspekte të tjera kushtetuese si; mosrespektimi i hierarkisë së normave, i parimit të rezervës ligjore, dhe delegimit ligjor, si dhe shumicës së kërkuar për miratimin e ligjit.

Kështu, në një çështje ku, Komiteti Shqiptar i Helsinkit pretendoi se ligji është antikushtetues, sepse shkelte nenin 81 të Kushtetutës, pasi nuk ishte miratuar në përputhje me procedurën dhe me shumicën e kërkuar dhe binte në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve ligjore, Gjykata çmoi se, kjo dispozitë kushtetuese është më tepër një dispozitë e karakterit procedural, dhe parashtrimin e një pretendimi të tillë, subjekti e ka të kushtëzuar, lidhur me pretendimet për të drejtat themelore të njeriut⁵.

9.5 A është kriter domethënës ekzistenca apo interesat e "anëtarësisë" për legjitimimin?

Kriteri i "anëtarësisë" mbetet akoma një kriter për t'u elaboruar dhe konsoliduar nga Gjykata Kushtetuese, se çfarë rëndësie do të duhej të kishte për legjitimimin, si kriter elastik apo statik, i paracaktuar si kusht legjitimimi.

Në një çështje, të iniciuar nga Qendra "Forumi i Mendimit të Lirë", e cila u legjitimua nga Gjykata, ajo shprehet se, kjo qendër është një organizatë jofitimprurëse, që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit në fuqi. Objekti i veprimtarisë së kësaj organizate, i parashikuar në statut,

⁵ Vendimi nr.4, datë 23.02.2011 i Gjykatës Kushtetuese

është dhe nxitja e zhvillimit të legjislacionit në fushën e arsimit, mbrojtja e interesave të ndryshme të institucioneve arsimore të çdo niveli, respektimi i parimit të autonomisë universitare si dhe promovimi i edukimit shoqëror e individual, bazuar në vlerat e demokracisë liberale, prandaj dhe ka interes për kundërshtimin e ligjit për arsimin e lartë⁶.

Sipas argumentimit të dhënë nga Gjykata, në rastin konkret për legjitimitimin është marrë si referencë objekti i veprimtarisë, dhe është lënë mënjane mungesa e anëtarësisë.

Po kështu, me vendimin nr.4/2011, palët e interesuara ngritën pretendime lidhur me faktin se Komiteti Shqiptar i Helsinkit si subjekt kërkuar, nuk provoi dot se ligji anti-mafia kishte cenuar interesat e anëtarësisë, por Gjykata e legjitimoi këtë subjekt, sepse ligjin objekt kundërshtimi e pa të lidhur jo me interesat e anëtarësisë, por me interesat e misionit dhe objektit të veprimtarisë së KSHH-së.

Ndërsa, me vendimin nr.7/2013, ku gjykata u vu në lëvizje nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Gjykata avancoi në qëndrimet e saj, edhe pse duke ngushtuar hapësirat për legjitimitim, se Qendra apo fondacionet, që krijohen pa anëtarësi sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse, nuk legjitimohen, pasi sipas Gjykatës me "interes të drejtpërdrejtë, të sigurt dhe vetjak" do kuptohen edhe interesat e anëtarësisë.

Gjykata vlerësoi, se Qendra nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, për arsye se nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis misionit për të cilin është krijuar apo veprimtarisë që ajo kryen dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat, të cilat kërkon të shpallen si të papajtueshme me Kushtetutën. Referuar statusit të saj juridik, si një qendër së cilës i mungon anëtarësia, ajo nuk përfaqëson interesa të anëtarëve të saj, por, në cilësinë e organizatës jofitimprurëse, ndjek një qëllim në të mirë dhe interes të publikut duke ofruar, ndër të tjera, ndihmë ligjore falas (*pro bono*) për disa shtresa të caktuara të popullsisë, të cilat nuk kanë mundësi të përballojnë financiarisht shërbimet e një mbrojtësi ligjor apo shpenzimet gjyqësore.⁷

10. Po ankimi kushtetues individual në cilat kushte dhe kritere ushtrohet nga OJF-të?

OJF -ja që përfaqëson interesat e një individi konkret, mund ta ushtrojë ankimin kushtetues individual në emër të të përfaqësuarit.

Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur:

a) kërkuar ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion;

⁶Vendimi nr.9, datë 19.03.2008i Gjykatës Kushtetuese

⁷ Në këtë çështje kanë qenë 3 gjyqtarë "kundër" për mungesën e legjitimitit të Qendrës.

b) kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit;
c) pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin;
ç) shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.”⁸

Në një çështje, ku kërkuesi, person fizik, i ishte drejtuar Gjykatës për shfuqizimin të ligjit për nr.138/2015, (dekriminalizimi), kjo Gjykatë u shpreh se: "... kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e dispozitave të ligjit, pasi e drejta për të bërë një ankim kushtetues individual, mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe vetëm nëse vërtetohet interesi i drejtpërdrejt i kërkuesit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës"⁹.

Pra, kërkuesi fillimisht duhet të ndjekë ankimin për aktin individual të dalë në zbatim të ligjit që ai pretendon si antikushtetues përmes sistemit gjyqësor të zakonshëm, dhe vetëm pasi të ketë shteruar rrugën gjyqësore, atëherë ai mund t'i drejtohet kësaj Gjykate, për shfuqizimin jo vetëm të vendimeve gjyqësore, por edhe të ligjit mbi bazën e të cilit janë dhënë këto vendime¹⁰.

Shembull: Një organizatë mbron në gjyq një të burgosur të dënuar, dhe kërkon lirimin para kohe me kusht të tij. Për këtë çështje ajo ndjek rrugën gjyqësore. Të burgosurit i është mohuar lirimi para kohe me kusht nga gjykatat, prandaj dhe organizata paraqet kërkesë në Gjykatë Kushtetuese. Ajo i kërkon gjykatës, shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, që kanë ardhur si pasojë e zbatimit të nenit përkatës të Kodit të Procedurës Penale, si dhe shfuqizimin e tij për kushtet e lirimimit para kohe me kusht, si antikushtetues, pasi bie ndesh me dinjitetin njerëzor, shpresën e njeriut për korrigjim dhe rehabilitim si dhe parimin e proporcionalitetit.

Sipas kritereve apo skemës së ankimit individual, organizata, ka shteruar mjetet efektive juridike, pasi ka kaluar të gjitha shkallët e gjyqësorit, ka paraqitur kërkesën brenda afatit 4- mujor nga marrja dijeni e vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Lartë, argumenton se pasojat janë reale dhe të drejtpërdrejta dhe se shfuqizimi i vendimeve gjyqësore, por dhe i nenit përkatës të ligjit do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të tij, pasi Kuvendi do të detyrohej të merrte nismë ligjvënëse tjetër në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, potencialisht në favor të tij, duke i mundësuar lirimin, para kohe me kusht.

Ky do të ishte rasti kur organizata do të ndiqte ankimin lidhur me procesin e rregullt substancial, duke ankimuar jo të drejta procedurale të shkelura të të burgosurit nga vendimi gjyqësor, por të drejta të lidhura me thelbin e gjykimit dhe përmbajtjen antikushtetuese të vetë ligjit.

⁸Neni 71 dhe 71/a i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese

⁹ Vendimi nr.23, datë 23.03.2017 i Gjykatës Kushtetuese

¹⁰Neni 71/b/2 i ligjit organik: Kur Gjykata Kushtetuese shqyrton kushtetutshmërinë e një akti dhe arrin në përfundimin se ai bazohet mbi një ligj ose akt normativ antikushtetues, gjykata vendos njëkohësisht edhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ.

11. Çfarë është kontrolli incidental, përmes gjykatave të zakonshme?

Organizatata mund ta ndjekin një çështje individuale dhe konkrete në rrugë gjyqësore të zakonshme, dhe gjatë shqyrtimit të saj të kërkojnë dërgimin e normës ligjore, që do zbatohet në çështjen konkrete në Gjykatë Kushtetuese. Këtë kërkesë mund ta bëjnë kur çështja është në shqyrtim, në çdo shkallë të gjyqësorit.

Kontrolli i akteve normative dhe paraqitja e tyre përmes gjyqësorit të zakonshëm është i nevojshëm sidomos në rastet kur OJF-ve i ka kaluar afati 2 - vjeçar, për paraqitjen e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin të ligjit apo aktit nënligjor.

Duke qenë se gjyqtarët mund të kërkojnë kontroll të normës në çdo kohë¹¹, atëherë kjo qasje rrit shanset për sukses të OJF-ve, të cilat për arsye të ndryshme nuk kanë arritur t'i drejtohen Gjykatës brenda afatit ligjor për ankimin.

Në një çështje, shqyrtuar nga Gjykata, e pandehura B.Q., është përfaqësuar nga Qendra për Nisma ligjore dhe Qytetare në gjykimin penal, e akuzuar për kryerjen e veprës penale të prostitucionit, parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal. Kjo Qendër i ka kërkuar gjykatave të zakonshme gjatë procesit, kundërshtimin e nenin 113 të KP në Gjykatë Kushtetuese, kërkesë të cilën ia ka pranuar Gjykata e Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendosi pezullimin e çështjes dhe dërgimin para Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e paragrafit të parë të nenit 113 të KP-së, sipas të cilit: “Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjër në tre vjet”¹².

Shembull: Një organizatë, për shkak të angazhimeve të shumta që ka, edhe pse e ka në misionin dhe veprimtarinë e saj mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, ndryshimet e legjislacionit për këtë kategori edhe pse kishte bindjen se ishin antikushtetuese, nuk arriti t'i kundërshtojë në Gjykatë, brenda afatit 2- vjeçar, duke humbur të drejtën e paraqitjes së kërkesës. Ajo gjithsesi, ishte duke ndjekur pranë gjykatës së rrethit çështjen e një personi me aftësi të kufizuara që i ishte mohuar statusi i të verbrit.

Gjatë procesit gjyqësor ajo i kërkon gjykatës që nëpërmjet rrugës incidentale t'i kërkojë Gjykatës Kushtetuese, antikushtetutshmërinë e dispozitës konkrete që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes, për shkak të cenimit të të drejtave sociale të të verbërve dhe cenimit të parimit të sigurisë juridike.

Duke ndjekur këtë metodë, kjo organizatë arrin të realizojë kontrollin e normës ligjore, edhe pse asaj i ka kaluar afati 2- vjeçar për kundërshtim, por që duke venë në lëvizje gjykatat, ato mund ta iniciojnë këtë kontroll në çdo kohë, pa afat ligjor.

¹¹ Neni 68/1 i ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese

¹² Vendimi nr.71, datë 27.11.2015 i Gjykatës Kushtetuese

12. A mund të kërkojnë ndërhyrjen si palë e interesuar në gjykim OJF-të?

OJF- të mund të kërkojnë edhe legjitimimin si palë e interesuar para Gjykatës, në rastet kur çështja është iniciuar nga subjekte të tjera kërkuuese. Legjitimimi i subjekteve përcaktohet nga Gjykata Kushtetuese mbi kërkesën e OJF - së, për ndërhyrje në proces si palë e interesuar¹³. Megjithatë, Gjykata mund të kërkojë pjesëmarrjen e OJF-së, konkrete kur e ka identifikuar si të tillë, që mund të ta ndihmojë procesin kushtetues, qoftë edhe kryesisht.

OJF -ja që ndërhyr si palë e interesuar, jo vetëm që vlerëson se mund të kontribuojë në çështjen që shqyrtohet, në marrjen e një vendimi sa më të drejtë, për shkak të ekspertizës apo veprimtarisë së saj, por mund edhe të bëhet palë me njërën nga palët ndërgjyqëse, që sipas saj është në interes publik, duke i kërkuar Gjykatës rrëzimin ose pranimin e kërkesës.

12.1. A mund të kërkojnë ndërhyrjen si *amicus curiae* në gjykim OJF-të?

Ndërhyrja si palë e interesuar apo si *amicus curiae*, në gjykim kushtetues nuk ka ndonjë dallim të madh, pasi roli dhe funksioni që luajnë është i njëjtë, megjithatë, si *amicus curiae* OJF-të, mund t'i ofrojnë gjykatës:

- informacion faktik, në formën e sondazheve, studimeve, hulumtimeve, raporteve statistikore, apo monitoruese, mbi perspektivën dhe pasojat konkrete, që mund të sjellë vendimi i saj, për grupe apo njerëz që nuk janë pjesë e procesit, por që vendimmarrja mund t'i impaktojë.
- asistencë, me qëllim që gjykata të kuptojë më mirë parimet apo dimensionin e të drejtave të njeriut në çështje, dhe tensionet që mund të sjellë zgjidhja e saj në një mënyrë ose tjetër, perspektivë që ndonjëherë e kanë vetëm OJF-të në kontekstin praktik;
- ekspertizë të mirëfilltë ligjore, të siguruar nga ekspertët e organizatës, e cila rrit argumentet për vendimmarrjen e çështjes dhe përdoret nga gjykata në argumentimin e vendimit;
- ndihmë, që gjykata të aplikojë në mënyrë të saktë dhe korrekte standardet e elaboruara, në kontekstin konkret, pasi ndodh që një gjykatë i njeh dhe i referohet standardeve ndërkombëtare dhe kur vjen çështja për t'i zbatuar, i interpreton gabim ato.

¹³Vendim nr. 29, datë 21.10.2009; nr.9, datë 23.03.2010 sipas të cilëve, GJK shprehet se: "Në çështjet me interes publik, interesi i drejtpërdrejtë i subjekteve të interesuara, duhet kuptuar si interes për të kontribuar në çështjen që shqyrtohet. Kështu që, vlerësimi i legjitimitetit të subjektit të interesuar bazohet në interes jo të subjektit vetë, por të gjykimit kushtetues".

OJF-ja që ndërhyr me *amicus curia*, nuk bëhet palë me ndonjë nga palët dhe vetëm jep informacion apo ekspertizë teknike si dhe siguron perspektivë të thellë dhe të gjerë mbi çështjen nga disa këndvështrime, por pa i paraqitur Gjykatës, konkluzione mbi pranimin ose rrëzimin e kërkesës. *Amicus curia*, nuk mban anë, por jep ekspertizë që duhet të perceptohet si e paanshme.

Në një çështje, të sipërpërmendur dhe më lart, për shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal për dënimin e ushtrimit të prostitucionit si vepër penale, Gjykata vendosi të thërrasë Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, (KMD). Po kështu, një qendër (QNLQ), që merrej me mbrojtjen e grave të trafikuar, dhe që pretendonte se në bazë të kësaj dispozite në dukje neutrale, dënoheshin vetëm gratë, kërkoj pjesëmarrjen si palë e interesuar, dhe u pranua nga gjykata si kërkesë.¹⁴ Në fakt, në këtë rast KMD kërkoj para Gjykatës pranimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit përkatës, dhe nuk ishte klasikisht në rolin *amicus curiae*, por sigurisht pozicionet procedurale të palëve të treta në gjykimin kushtetues, duan kohën e vet të kuptohen dhe të zbatohen si duhet.

12.2 Cilat faktorë dhe qasje strategjike duhet të konsiderojë një OJF, për ndërhyrje në gjykimin kushtetues?

Për të ndërhyrë si palë e interesuar/*amicus curia* në gjykimin kushtetues, një OJF, duhet të ketë parasysh:

- identifikimi i çështjeve që janë në shqyrtim para Gjykatës dhe koha e mjaftueshme për t'u përgatitur për ndërhyrjen;
- nëse çështja ka lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- nëse vendimi i gjykatës do të jetë i tillë që do të ketë impakt të lartë publik, që shkon përtej palëve konkrete, apo një kategorie të caktuar individësh;
- nëse çështja është e tillë, që gjykata do formulojë standarde edhe për të ardhmen;
- nëse vetë OJF ka mjaftueshëm të dhëna, analiza dhe statistika, ekspertizë, që provojnë pretendimet ose i rrëzojnë ato;
- çfarë interesash të tjera mund të ketë në çështje dhe cilat janë ato? A janë të tilla, si interesa që mund të konvergojnë me interesin e OJF-së?
- a përbën kauzë çështja në fjalë, dhe a është e lehtë për t'u përthithur nga publiku i gjerë apo Media?
- a do jetë e tillë vendimmarrja e gjykatës që ta adresojë problematikën kushtetuese dhe zgjidhjen e çështjes në mënyrë efektive?
- çfarë perspektive mund të marrë çështja pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, që mund të pranojë apo rrëzojë kërkesën?
- a ka qartësi ligjore dhe kushtetuese si problematikë dhe a do të ishte Gjykata Kushtetuese, mënyra më e mirë dhe e vetme, si mjet ankimi efektiv?

¹⁴ Vendimi nr.71, datë 27.11.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

Shembull: Gjykata është duke shqyrtuar një çështje lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore dhe parashikimet mbi këtë vepër penale në Kodin Penal, iniciuar nga Avokati i Popullit. Ky subjekt kërkes ka ngritur pretendime mbi parimin e proporcionalitetit, që është një parim i natyrës praktike, pra kërkon aplikimin e testit të përshtatshmërisë, domosdoshmërisë, si dhe nevojshmërisë të masës së marrë në kufizim të të drejtave të njeriut për të realizuar qëllimin e ligjëvënës.

Që të ketë sa më shumë statistika mbi gjendjen reale të subjekteve që kryejnë këtë vepër penale, viktimave, apo dhe efektivitetin e zbatimit të ligjit nga organet kontrolluese, gjykata thërret në gjykim 2 organizata, që veprojnë në këtë drejtim, si palë të interesuara, me qëllim marrjen e mendimit të tyre për nevojat e gjykimit kushtetues. Këto organizata i kërkojnë gjykatës, pranimin e kërkesës së Avokatit të Popullit, duke u bërë palë me palën kërkuese.

Gjithashtu, edhe një organizatë e tretë, sapo merr dijeni për gjykimin e kësaj çështje, i kërkon Gjykatës, ndërhyrjen në proces si *amicus curiae*, duke paraqitur një ekspertizë ligjore mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane të lidhura me çështjen konkrete, kërkesë të cilën Gjykata e pranon. Kjo organizatë nuk jep mendim mbi përfundimin e çështjes konkrete.

13. A mund të bashkohen me subjekte të tjera të legjitimuara si institucionet që kanë mision mbrojtjen e të drejtave të njeriut?

Organizatat mund të bashkëveprojnë me Avokatin e Popullit, ose komisionerët e të drejtave të njeriut, dhe t'i drejtohen bashkërisht me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, si një formë më cilësore, e cila rrit shanset për kalim në seancë të kërkesës.

Aktualisht veprojnë dy komisionerë si organe administrative të pavarura; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe të Dhënat Personale, që përveçse mund të vihen në lëvizje për shqyrtim administrativ me kërkesë nga individ, ose OJF-të, kanë dhe kompetenca monitorimi, si dhe fillimi të çështjes me iniciativë, pa ankesë nga individët, nëpërmjet inspektimeve. Komisionerët e institucionit të Avokatit të Popullit nuk duhen ngatërruar me këta dy komisionerë, pasi ata veprojnë nën autoritetin dhe kompetencën e institucionit të Avokatit të Popullit dhe jo si komisionerë më vete¹⁵.

Në një çështje, Komiteti i Helsinkit, Avokati i Popullit dhe Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, iu drejtuan Gjykatës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.43, datë 27.01.2006 "Për shmangien e nepotizmit dhe ndikimin e

¹⁵ Sipas ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, me ndryshimet përkatëse, "Për Avokatin e Popullit", neni 31, parashikohet se: "Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në pesë seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët. Këto seksione janë:

1. Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.
2. Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.
3. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruës.
4. Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.
5. Seksioni i përgjithshëm".

pushtetit në rekrutimin dhe karrierën e personelit të administratës publike”; nr. 44, datë 27.01.2006 “Për shmangien e nepotizmit në administratën publike” dhe nr. 48, datë 27.01.2006 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”¹⁶. Kjo kërkesë rezultoi e suksesshme dhe u pranua nga Gjykata.

Shembull: Një organizatë kërkon shfuqizimin e ligjit për tarifën gjyqësore me pretendimin se mbart potencialisht shkelje kushtetuese të parimit të aksesit në gjykatë dhe të proporcionalitetit, në respekt të neneve 42 dhe 17 të Kushtetutës, ndërkohë në objektin e veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e grupeve vulnerabël, por akoma nuk ka ndjekur në praktikë çështje të tilla, ku të duhet të aplikojë mbrojtje për individë të përjashtuar nga tarifa gjyqësore. Ajo i drejtohet Avokatit të Popullit, i cili mund ta ketë ose mund të mos ta ketë në vëmendje kundërshtimin e ligjit në Gjykatë, por është organizata ajo që bashkëvepron dhe i afrohet këtij institucioni të paraqesin kërkesën bashkërisht.

Nisur nga normat kushtetuese dhe jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me legjitimitimin, organizata nuk legjitimohet, për shkak se nuk vërteton dot cenimin real të ardhur nga zbatimi i ligjit, megjithatë Kolegji i Gjyqtarëve/ Mbledhja e Gjyqtarëve do të kalojë çështjen në seancë gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës për shfuqizimin e ligjit, për shkak të legjitimitit të Avokatit të Popullit, i cili tashmë me ndryshimet kushtetuese nuk ka detyrime për të vërtetuar interesin personal dhe vetjak.

Kështu që, organizata thjesht duke ndryshuar qasjen ndaj kontrollit kushtetues, rrit rolin e saj mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individit dhe teston kushtetutshmërinë e ligjit, nëpërmjet vënies në lëvizje të Avokatit të Popullit, pa e lënë të prezumohet si i tillë, kur ajo ka dyshime të arsyeshme mbi antikushtetutshmërinë.

14. Po me njëra- tjetrën a mund të bashkëveprojnë organizatat, për t’iu drejtuar Gjykatës?

Organizatave mund të bashkëveprojnë edhe me njëra -tjetrën, për të rritur mundësitë për një kërkesë cilësore para Gjykatës Kushtetuese.

Në të shkuarën, organizatat veç e veç i janë drejtuar Gjykatës dhe më pas ajo ka proceduar me bashkimin e çështjeve, kur objekti dhe natyra e pretendimeve ka qenë e njëjtë. Shoqata Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi” dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit i janë drejtuar, veçmas, Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, pasi parashikonte të drejtën e rishikimit të vendimeve të AKKP-së, në cenim të sigurisë juridike dhe parimit të ndarjes së pushteteve, parashikuar në nenin 7 dhe 135 të Kushtetutës¹⁷.

¹⁶ Vendimi nr.20, datë 11.07.2006 i Gjykatës Kushtetuese

¹⁷ Vendimi nr.43, datë 06.10.2011 i Gjykatës Kushtetuese

III. MBI PROCESIN GJYQËSOR KUSHTETUES

15. Mbi çfarë baze ligjore vepron Gjykata Kushtetuese?

Procesi gjyqësor kushtetues, është një tërësi rregullash për paraqitjen e kërkesave dhe shqyrtimin e tyre, parimet dhe rregullat e gjykimit kushtetues, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre, të sanksionuara në ligjin organik të GJK. Megjithatë, si ligje plotësuese të ligjit organik të GJK janë dhe dispozitat ligjore të tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes dhe më konkretisht; Kodi Procedurës Civile, Kodi Procedurës Penale, Kodi Zgjedhor, etj. Kështu që, shpesh herë si bazë ligjore e kërkesës për zgjidhjes e çështjes në Gjykatë nga OJF- të duhet të referohen edhe dispozita të përcaktuara në ligje të tjera.

Gjithashtu, duhet mbajtur në konsideratë nga OJF- të, që KEDNJ dhe jurisprudenca e GJEDNJ duhet të jetë një burim i domosdoshëm për referim në kërkesë, për raste të ngjashme, si modele pozitive në interes të gjykimit kushtetues. Kjo pasi, Gjykata Kushtetuese, i referohet vendimmarrjes së GJEDNJ -së dhe standardeve të vëna nga kjo gjykatë gjatë gjykimit kushtetues për çështje të lidhura me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

16. Çfarë kushtesh dhe kriteresh formale duhet të plotësohen nëpërmjet kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese?

Kërkesa paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit në gjykim dhe duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe adresën e Gjykatës Kushtetuese;
- b) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vend-banimin ose vendqëndrimin e kërkuarit dhe/ose të përfaqësuesit me tagra përfaqësimi për OJF-në;
- c) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vend-banimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara dhe/ose të përfaqësuesve; ç) objektin e kërkesës dhe bazën ligjore;
- d) parashtrimin e shkaqeve dhe shkeljet e natyrës kushtetuese të pretenduara;
- dh) dokumentet, provat, apo materiale të tjera që shoqërojnë kërkesën;
- e) kopje të noterizuara të të gjitha vendimeve objekt kërkesë, si dhe të ankimeve dhe rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore;
- ë) nënshkrimin e kërkuarit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe aktin e përfaqësimit të këtij të fundit.

Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet statuti i OJF-së, vërtetimi i Zyrës së Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe çdo lloj dokumentacioni tjetër, që konsiderohet ndihmues në këndvështrim të të provuarit të interesit të ligjshëm të OJF-së përkatëse. Në rast se OJQ -ja ka zgjedhur të përfaqësohet nga një avokat, ajo i bashkëngjit kërkesës aktin e përfaqësimit. Në një rast të tillë, të gjitha njoftimet e Gjykatës i drejtohen përfaqësuesit të saj.¹⁸

Përveç kriterëve formale, duhet mbajtur parasysh argumentimi i interesit (*sipër shpjeguar, pyetja 9.1.*), si dhe analizë dhe argumente mbi shkeljen konkrete të pretenduar, të së drejtës kushtetuese. OJF- ja, duhet të parashtrojë jo vetëm argumente mbi legjitimitimin, por edhe argumente mbi shkeljen e pretenduar të së drejtës kushtetuese, që vjen nga dispozitat ligjore.

Shembull: Shoqata për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar (PAK), paraqet para Gjykatës, kërkesë për antikushtetushmërinë e një dispozite të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Sipas saj, personat me aftësi të kufizuar trajtohen në mënyrë të diferencuar nga ligji në raport me grupet e tjera, duke mos respektuar nenin 18 të Kushtetutës. Ky ligji, përdor termin "barrë e tepruar" për personat PAK, duke i dhënë përkufizim antikushtetues si dhe nuk diferencon shoqatat me anëtarësi PAK nga shoqatat që mbrojnë PAK. Për këto pretendime, ajo paraqet argumente të natyrës kushtetuese, ligjore dhe faktike. Si argumente të natyrës kushtetuese, parashtrohet Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, e cila sipas tyre jep mbrojtje më të lartë se ligji shqiptar me përkufizimet e saj. Si argument të natyrës ligjore, parashtrohet gjuhën e përdorur nga ligji, terminologjinë dhe përkufizimet e dhëna, të cilat përbëjnë diskriminim. Si argumente të natyrës faktike, sjell statistika dhe analiza të çështjeve gjyqësore, të gjykuara pranë gjyqësorit të zakonshëm dhe problematika që shoqëron zgjidhjen e çështjes nga gjykata, për shkak të dispozitës ligjore, sipas tyre antikushtetuese¹⁹.

17. Si bëhet komunikimi me Gjykatën?

Drejtoria Gjyqësore e Gjykatës vihet në kontakt me kërkuesin, nëse kërkesa ka nevojë për plotësime apo qartësime. Po ashtu dhe kërkuesi mund të kërkojë informacion para Gjykatës, për fazat e kërkesës, apo çdo lloj informacioni që e çmon të nevojshëm, në kuadër të së drejtës për informim.

Kërkuesi ose përfaqësuesi i tij mund të kërkojnë me shkrim që komunikimi me ta për çdo lloj njoftimi të bëhet nëpërmjet postës elektronike, si mënyrë e ligjshme dhe e parashikuar tashmë komunikimi në rregullat e reja procedurale të njoftimit, sipas Kodit të Procedurës Administrative, si dhe Kodi i Procedurës Civile.

¹⁸ Neni 27 i Ligjit organik të GJK

¹⁹ Vendimi nr.48, datë 15.11.2013 i Gjykatës Kushtetuese

18. A ka tarifë gjyqësore për akses në gjykimin kushtetues?

Shpenzimet e procesit gjyqësor para Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore. Kur Gjykata Kushtetuese vendos pranimin e ankimit individual kushtetues, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi.

Ligji mbi përcaktimin e tarifës gjyqësore të përgjithshme, parashikon se tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese është 5000 (pesë mijë) lekë, me përjashtim të rasteve kur palët ndërgjyqëse kanë bërë kërkesë për ndihmë juridike²⁰.

19. A është e domosdoshme të mbrohes me avokat në gjykimin kushtetues?

OJF -të në gjykimin kushtetues mbrohen vetë, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre sipas parashikimeve në statut apo vendimmarrjes së organeve drejtuese, si dhe nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor/avokat. Kur çështja kalon për gjykim dhe objekt kërkesë është një ligj ose akt normativ, përfaqësimi në gjykim duhet realizuar domosdoshmërisht me avokat ose përfaqësues ligjor të specializuar.

20. Sa kohë kanë OJF-të në dispozicion, për t'iu drejtuar Gjykatës nga marrja dijani për shkeljen e pretenduar?

Me dispozitat e reja ligjore, afatet ligjore për shfrytëzimin e kontrollit kushtetues, janë shkurtuar dhe kanë përmirësuar në parim sigurinë juridike të individëve, apo palëve ndërgjyqëse. Kështu afatet për kundërshtimin e ligjeve apo akteve nënligjore kanë qenë 3 vjet, nga hyrja në fuqi e aktit, ndërsa aktualisht kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, mund të paraqiten **brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit**²¹.

Ndërsa, për ankimin kushtetues individual, me objekt procesin e parregullt ligjor procedural, afati ka qenë jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes. Me ndryshimet e ligjit, për ankimin kushtetues individual me objekt shfuqizimin e një vendimi gjyqësor apo akti individual për të cilin nuk ka mjete të tjera ankimi, **individët mund të paraqesin kërkesë brenda**

²⁰ Ligji nr.98/2017, "Mbi tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë", neni 5/4, dhe neni 9

²¹ Neni 50/1 i ligjit organik të GJK.

4 muajve nga konstatimi i cenimit²². Me fillim të konstatimit të cenimit, do të kuptohet data kur individi merr dijeni për aktin e arsyetuar, që do të kundërshtojë, qoftë vendim gjyqësor apo akt administrativ. Kërkuesi ka barrën e provës për të provuar momentin e marrjes dijeni për vendimin gjyqësor të kundërshtuar apo aktin individual të nxjerrë nga pushteti publik, objekt kundërshtimi në Gjykatë²³.

Me qëllim të përlllogaritjes së afatit 4- mujor nga konstatimi i cenimit, OJF- të duhet të vërtetojnë datën e marrjes dijeni, apo datën e konstatimit të shkeljes, duke e shoqëruar me dokumentacionin dhe argumentet përkatëse.

21. Cilat janë fazat e ndryshme të shqyrtimit në të cilën gjendet kërkesa?

Në mënyrë të përmbledhur, procesi kushtetues mund të ndahet në katër faza kryesore:

- Kur kërkesa paraqitet në Gjykatë, pasi kalon fazën e regjistrimit dhe caktimit të relatorit, ajo mund të jetë në fazë përgatitjeje pranë gjyqtarit relator, gati për kolegji, ose në Mbledhjen e Gjyqtarëve, (*shqyrtimi paraprak*);
- Nëse këto dy instanca vendosin kalimin, çështja përgatitet për seancë gjyqësore, (*shqyrtimi gjyqësor*);
- Nëse seanca është realizuar, çështja është në proces diskutimi dhe marrje vendimi, (*vendimmarrja*);
- Pasi është marrë vendimi, çështja është në proces shpallje dhe njoftimi të palëve, (*shpallja*).

22. Si është procedura e shqyrtimit paraprak në Kolegje/Mbledhjen e Gjyqtarëve?

Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji, i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori. Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton themelin e çështjes në këtë fazë, por vendos veç kalimin ose mos kalimin në seancë plenare.

Mos kalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur: a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese; b) kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet; c) kërkesa është paraqitur nga një person i paautorizuar; ç) vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor; d) kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion; dh) kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është e mundur; e) kërkesa është haptazi e pabazuar.

²² Ibid, neni 50/4

²³ Vendimet e mos kalimit nr.3, datë 16.01.2018; nr.7, datë 18.01.2018 të Gjykatës Kushtetuese

23. A mund të kërkohet pezullimi ligjit/aktit nënligjor apo vendimit gjyqësor?

OJF -të mund t'i drejtohen Gjykatës, për pezullim të aktit, derisa të shprehet Gjykata me vendim përfundimtar. Këtë kërkesë OJF mund ta paraqesë së bashku me kërkesën kryesore, kur vlerëson se, se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shoqërorë ose të individëve sipas rastit, ose ditën e caktuar për seancë gjyqësore. Është Gjykata, ajo që me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Pezullimi vazhdon derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi²⁴.

Në lidhje me kërkimin e masës së pezullimit, elementët që duhet të vlerësohen nga OJF-të, dhe që duhet t'ia parashtrojnë Gjykatës janë:

- Dyshimi i fortë për antikushtetutshmërinë e normës apo aktit të pretenduar si antikushtetues;
- Prania e një urgjence;
- Dëm i rëndë ndaj një apo më shumë individëve dhe të drejtave të tyre të ligjshme;
- Dëm ndaj interesave shtetërore;
- Kujdes i duhur, në rastet e një akti ku implikohet jo vetëm çështje e natyrës juridike;
- Argumentim mbi baza krahasimore i avantazheve dhe disavantazheve të efekteve nga marrja e masës së pezullimit, ose refuzimi i marrjes së masës së pezullimit.

Në çështjen lidhur me kundërshtimin e vendimeve të "nepotizmit", Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe palët e tjera kërkuese, kërkuan pezullimin e vendimeve, kërkesë e cila u pranua. Në një çështje tjetër, KSHH në kërkesën për ligjin "anti-mafia" kërkoi pezullimin, kërkesë e cila u rrëzua, me argumentin se Gjykata nuk gjeti argumente bindëse për mundësinë e cenimit të interesave shtetërorë e shoqërorë ose të individëve, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të objekt kundërshtimi. Po kështu, në çështjen për ligjin e "lustracionit", u kërkua pezullimi, kërkesë e cila u pranua, me argumentin se shkaqet e parashtuara nga kërkuesit lidhur me kërkesën për pezullimin e ligjit, ishin shkaqe të përligjura për të argumentuar parandalimin e pasojave që mund t'i vijnë funksionimit normal të shtetit të së drejtës si dhe të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Sikundër konstatohet, pranimi ose jo i kërkesës për pezullim jo gjithmonë është tregues i perspektivës së çështjes për themelin e kërkesës.

24. Nëse OJF dëshiron të heqë dorë nga gjykimi, a mund ta bëjë këtë?

²⁴ Neni 45 i ligjit organik të GJK

Po, nëpërmjet një kërkesë drejtuar Gjykatës, e cila vetëm kur vendos se çështja ka interes publik vazhdon me gjykimin, pavarësisht vullnetit të kërkuarit.

25. Si realizohet komunikimi mes OJF-ve dhe Gjykatës, kur çështja pranohet për shqyrtim prej saj?

Drejtoria Gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, si rregull, 30 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare, njofton për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare, publike ose mbi bazë të dokumenteve, me përjashtim të rasteve kur Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.

Mos njoftimi i rregullt shkakton shtyrjen e seancës plenare, duke caktuar një datë tjetër për zhvillimin e saj, si dhe duke bërë njoftimet përkatëse. Kur megjithëse janë njoftuar palët, dhe nuk paraqiten në seancë plenare ose nuk dërgojnë dokumente shtesë, seanca plenare zhvillohet edhe në mungesë. Kur seanca zhvillohet mbi bazë dokumentesh, mosparaqitja brenda afatit të përcaktuar dhe pa shkaqe të përligjura e parashtrimeve nga kërkuari dhe e prapësimeve nga subjekti/et i/e interesuara passjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e kërkesës dhe/ose dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit.

26. Çfarë të drejtash kanë OJF- të gjatë gjykimit kushtetues si palë në proces?

Procesi i rregullt procedural, jo vetëm është standard i kontrollueshëm nga Gjykata Kushtetuese, si drejtë themelore e individit me anë të së cilës ai mbron të drejtat substanciale, por është dhe detyrim i vetë Gjykatës, për ta zbatuar në procesin gjyqësor kushtetues.

Të drejtat procedurale të palëve në një proces gjyqësor, mund të zbërthehen sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, konkretisht në të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, të drejtën për njoftim/ informim, të drejtën për t'u dëgjuar publikisht nga një gjykatë e pavarur e paanshme e caktuar me ligj, të drejtën për marrje dijeni të padisë/ akuzës, provave e fakteve të palës kundërshtare, të drejtën për t'u mbrojtur me avokat të zgjedhur vetë, ose të caktuar nga gjykata; barazia e armëve, ose ndryshe parimi i kontradiktoritetit, e drejta për të thirrur ekspertë ose dëshmitarë, gjykimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm, e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

OJF-të si të gjithë pjesëmarrësit në procesin e gjykimit para Gjykatës Kushtetuese kanë të gjitha të drejtat e sipërpërmendura, dhe të konfirmuara edhe nga ligji organik i GJK, posaçërisht si: a) të njihen me dokumentet e dosjes, të marrin ekstrakte ose fotokopje të tyre; b) të marrin pjesë në shqyrtimin e provave; c) të paraqesin prova; ç) t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, dëshmitarëve, ekspertëve e specialistëve; d) të paraqesin kërkesa; dh) të japin shpjegime me shkrim ose me gojë;

e) të paraqesin përfundimet e tyre; ë) të kundërshtojnë kërkesat e palëve të tjera, përfundimet dhe shpjegimet e tyre, si dhe të paraqesin pretendime përfundimtare.

Ato, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit²⁵.

27. A mundet OJF - të, t'i kërkojnë Gjykatës opinion këshillimor nga GJEDNJ?

OJF- të aktive edhe në mbrojtjen e viktimave para GJEDNJ, mund të shfrytëzojnë hapësirën e re ligjore për kërkim opinionit këshillimor nga GJEDNJ, gjatë procesit kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese.

Kështu OJF-të, që përfaqësojnë individë, mund t'ia parashtrojnë kërkesën Gjykatës Kushtetuese, e cila, gjatë shqyrtimit të çështjes, vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj, duke pezulluar shqyrtimin e çështjes²⁶.

Në rastet e ankimit individual, që me hyrjen në fuqi të protokollit nr.16, gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata vendos, me iniciativë ose me kërkesë që të ushtrojë të drejtën për kërkimin e një *amicus curia* në GJEDNJ.

28. Sa zgjat procesi gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese?

Ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk ka afate fikse të përcaktuara, përveç disa gjykimeve të posaçme dhe rasteve përjashtimore të shqyrtimit, gjykimit dhe shpalljes së vendimit. Një afat i përcaktuar qartë është shqyrtimi i çështjes për kalim ose jo në seancë gjyqësore brenda 3 muajve, si dhe shpallja e vendimit të arsyetuar brenda 30 ditëve nga seanca gjyqësore. Ky ligj, përtej këtyre dy afateve, parashikon se çështja në Gjykatë duhet të përfundojë brenda afateve të arsyeshme²⁷.

29. Kur çështja zgjat tej afatit të arsyeshëm, a mund të kërkohet dëmshpërblim?

²⁵ Neni 43/b i Ligjit organik të GJK

²⁶ Neni 44/b/1 i Ligjit organik të GJK. Kjo dispozitë futet në veprim nga 1 Gusht 2018, me hyrjen në fuqi të protokollit 16 të KEDNJ.

²⁷ Neni 71/b/4 i ligjit organik të GJK

Kur pretendohet nga palët se gjykimi është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, ata kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese, nëse konstatohet se nga tej zgjatja e procesit atij/asaj i janë cenuar të drejtat dhe liritë të parashikuara nga Kushtetuta.

Kjo lloj kërkesë mund të paraqitet vetëm pasi ka kaluar të paktën një vit nga fillimi i shqyrtimit të çështjes.

Gjykata Kushtetuese, në çdo rast, vlerëson natyrën e procesit dhe të çështjes, si dhe rrethanat që kanë ndikuar në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese. Ajo vendos për masën e dëmshpërblimit, duke iu referuar pasojave që i kanë ardhur kërkuarit nga tej zgjatja e procesit para saj. Nëse Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se gjykimi është zgjatur tej afatit, pa shkak të arsyeshëm, atëherë ajo dëmshpërblen kërkuarin deri në masën 100 000 lekë për çdo vit vonesë.²⁸

30. A janë të hapura për publikun diskutimet e gjyqtarëve për çështjen?

Bisedimet si dhe votimi i vendimit bëhen pa praninë e personave të tjerë.

31. Cili është dallimi mes një vendimi dhe një vendimi përfundimtar?

Vendimi jepet nga Kolegji, i përbërë nga 3 gjyqtarë, ose Mbledhja e Gjyqtarëve e përbërë nga 6 deri 9 gjyqtarë, mbi kalimin ose mos kalimin në seancë plenare. Vendimi përfundimtar jepet nga Gjykata pas shqyrtimit në seancë gjyqësore të kërkesës, e cila vendos mbi themelin e kërkesës.

32. Si bëhet shpallja e vendimit të Gjykatës Kushtetuese?

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet. Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shpallet i arsyetuar. Në raste të veçanta që kanë të bëjnë me çështje të rëndësisë publike, Gjykata Kushtetuese mund të njoftojë dispozitivin e vendimit menjëherë pas marrjes së tij dhe shpall vendimin e arsyetuar brenda 5 ditëve. Në këtë rast, vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij bashkë me arsyetimin, përveç rasteve kur gjykata vendos ndryshe.²⁹

33. Cilat janë efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese?

²⁸ Neni 71/ç i ligjit organik të GJK

²⁹ Neni 72 i ligjit organik të GJK

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që vendimi për shfuqizimin e një akti të prodhojë pasoja në një datë tjetër të ndryshme nga hyrja e tij në fuqi. Kur Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të një çështjeje, konstaton se ka boshllëk ligjor, si rrjedhojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, veç të tjerave, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar.

Vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga momenti i marrjes së tyre.

34. A mundet që pas një vendimi të dhënë nga Gjykata Kushtetuese të ankimosh përsëri të njëjtin vendim pranë saj?

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të vihen më në diskutim as nga vetë kjo Gjykatë, për rrjedhojë nuk mund të ankimohet përsëri një vendim i dhënë nga Gjykata Kushtetuese, qoftë ky vendim Kolegji apo vendim përfundimtar i Gjykatës.

35. A mund të ketë rihapje të procesit gjyqësor kushtetues nga Gjykata Kushtetuese?

Po, mund të ketë vetëm në dy raste:

- Nëse një gjykatë ndërkombëtare konstaton se Republika e Shqipërisë ka shkelur detyrimin që rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare dhe, si rrjedhojë, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi fizik ose juridik nëpërmjet një ligji ose akti normativ, Gjykata Kushtetuese, me kërkesë, mund të shfuqizojë ligjin ose aktin normativ nëse konstaton se nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtat e cenuara;
- Nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit gjyqësor³⁰.

36. Si ekzekutohen vendimet e Gjykatës?

³⁰ Neni 71/c i Ligjit organik të GJK

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të vet ekzekutueshme. Ato nuk vihen në diskutim. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave me anën e organeve përkatëse të administratës shtetërore. Gjykata Kushtetuese, në varësi të llojit të vendimit dhe kur është e nevojshme, mund të caktojë në pjesën urdhëruese organin e ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit. Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal³¹.

37. Për cilat të drejta kushtetuese të individit ngrihen më tepër pretendime në Gjykatë?

Kërkesat që zënë vendin më të madh sipas statistikave janë të lidhura me procesin e rregullt ligjor procedural, dhe konkretisht me elementët e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës në kontekstin e proceseve civile, penale apo administrative, për shkak të kompetencës së kufizuar që ka pasur Gjykata në të kaluarën. Me ndryshimet e reja ligjore, do të ketë rezultate të tjera statistikore, që do të evidentojnë të drejtat themelore, për të cilat kërkuesit ankohen më tepër.

Ndërsa kërkesat lidhur me kontrollin e akteve ligjore, nënligjore, mosmarrëveshjen e kompetencës, e të tjera, zënë më pak vend në veprimtarinë e Gjykatës dhe janë të lidhura me pretendime të natyrave të ndryshme kushtetuese, sipas rastit konkret.

38. A jep zgjidhje Gjykata për çështje që shqetësojnë shoqërinë dhe për tema të cilat evoluojnë me kohën?

Sigurisht që në Gjykatë mund të shtrohen për diskutim kushtetues edhe çështje që shqetësojnë përgjithësisht shoqërinë, aktualisht, si të drejtat e personave LGBT, martesat mes tyre, diskriminimi për arsye gjinie, profesioni, feje, etj., apo dhe të dhënat personale dhe ndërhyrja e shtetit në të drejtën e individit për jetë të qetë private.

Gjykata, ka pasur raste të elaborojë standardet kushtetuese të mos diskriminimit, për çështje që janë shtruar para saj me kërkesë nga subjektet e interesuara. Një rol të rëndësishëm në dhënie përgjigje juridike kushtetuese këtyre problemeve, luan dhe shoqëria civile, që sigurisht mund ta investojë Gjykatën, e cila nuk mund të shqyrtojë çështje me iniciativën e saj.

³¹ Neni 81 i Ligjit organik të GJK

IV. DISA PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Roli i shoqërisë civile në mbrojtjen e vlerave kushtetuese është shumë i rëndësishëm. Demokracia kushtetuese ka nevojë për një shoqëri civile të gjallë që të veprojë në mënyrë të pavarur dhe si një mbikëqyrës mbi qeverinë - veçanërisht në lidhje me arritjen e qëllimeve kushtetuese. Siç është demonstruar edhe nga praktika e Gjykatës Kushtetuese shqiptare, ka një numër në rritje të organizatave dhe grupeve të shoqërisë civile që i drejtohen Gjykatës, por edhe që kanë arritur sukses për çështjet e paraqitura në këtë Gjykatë. Kjo tregon një prirje pozitive dhe nivel më të lartë edukimi, promovimi dhe mbrojtjeje të të drejtave të njeriut nga shoqëria civile, por është dhe tregues i rritjes së besimit ndaj kontrollit kushtetues. Nga perspektiva e vetë OJF-së, frekuenca dhe cilësia e ndërhyrjes në procesin kushtetues e ndihmon atë të ekspozohet më tepër, të rrisë autoritetin mes anëtarësisë, të përthithë anëtarë të rinj, dhe të përthithë më tepër fonde për përmbushjen e misionit dhe funksioneve të saj, në mbrojtje dhe promovim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Disa sugjerime praktike për OJF -të, janë:

- informim i individëve për të drejtat kushtetuese dhe aksesin në gjykimin kushtetues edhe për procesin e rregullt substancial, nëpërmjet ankimit kushtetues individual;
- qasje më cilësore për një sukses të çështjes, nëpërmjet vënies në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese vetë OJF-ja së bashku me OJF, të tjera të fushës, ose në bashkëpunim me institucione publike, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut;
- strategji mbrojtëse më efikase para Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet shfrytëzimit të rrugës së kontrollit incidental përmes gjykatave të zakonshme, kur i janë drejtuar rrugës gjyqësore për zgjidhjen e çështjes penale, civile, administrative, etj.;
- monitorim i akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën, në drejtim të respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut;
- rol parandalues të ardhjes së pasojave negative për të drejtat dhe liritë themelore, nëpërmjet sensibilizimit dhe bashkëpunimit për çështjet konkrete tek Avokati i Popullit;
- adresim të çështjes së antikushtetutshmërisë së ligjit apo aktit nënligjor dhe ankimit pranë Avokatit të Popullit, si subjekt i pakushtëzuar për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese;
- asistimi i viktimave për ankim pranë OJF-ve, ose organeve administrative, me qëllim që të provohet cenimi real dhe pasoja konkrete e dëmshme e të drejtave para Gjykatës Kushtetuese për qëllime legjitimimi;
- përfaqësim ligjor cilësor i interesave të individëve/shtetasve, ose të anëtarësisë, apo përfaqësim ligjor sipas misionit apo statutit në procesin gjyqësor kushtetues, përmes avokatëve, apo personave të specializuar në fushën kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut.

- sa më shumë rol *amicus curia*, për të përfaqësuar interesin publik dhe për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik në çështje që i interesojnë shoqërisë, duke dhënë mesazhin se ata janë të vëmendshëm (*watchdog*) në ndërhryjet e shtetit ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- ndërhryje cilësore si *palë e interesuar*, me qëllim që të afirmojnë dhe konfirmojnë reputacionin si ndërhryës serioz dhe domethënës, në proces kushtetues, edhe pse gjykata mund të ketë vendosur ndryshe.

A. Ekstrakt i Kushtetutës

Neni 131

1. Gjykata Kushtetuese vendos për:

- a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në Nenin 122;
- b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;
- c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
- d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas Nenit 9 të kësaj Kushtetute;
- dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;
- e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës dhe të deputetëve, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;
- e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre.”
- ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
- f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.
- f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Neni 134

Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të:

- a) Presidentit të Republikës;
- b) Kryeministrit;
- c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;
- ç) Avokatit të Popullit;
- d) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- dh) çdo gjykatë, sipas nenit 145, pika 2, të kësaj Kushtetute;

- e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta;
 - ë) Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
 - f) organeve të qeverisjes vendore;
 - g) organeve të bashkësive fetare;
 - gj) partive politike;
 - h) organizatave;
 - i) individëve.
2. Subjektet e parashikuara nga nën paragrafët “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

B. Ekstrakt i Ligjit Organik të GJK

Neni 49(ndryshohet me ligjin nr.99/2016, neni 42)

Subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

1. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit.
2. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin vetëm të respektimit të procedurës së parashikuar nga Kushtetuta, sipas nenit 131, pika 2, dhe nenit 177, të Kushtetutës, e kanë Presidenti i Republikës dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve.
3. Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe:
 - a) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
 - b) organet e qeverisjes vendore, kur pretendojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre të parashikuara në Kushtetutë ose pozita e tyre kushtetuese;
 - c) komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, kur gjatë veprimtarisë së tyre konstatojnë se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;
 - ç) Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë kushtetuese të tyre ose pozitën juridike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
 - d) organet e bashkësive fetare, partitë politike, organizatat, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre;
 - dh) gjykatat e të gjitha niveleve, kur gjatë gjykimit të një çështjeje konstatojnë se ligji ose akti normativ bie ndesh me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare;
 - e) individët, kur pretendojnë se u cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim, si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.

4. Subjektet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre.

Neni 50*(ndryshohet me ligjin nr.99/2016, neni 43)*

Afati i paraqitjes së kërkesës

1. Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 49, të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.

2. Kërkesat për kushtetutshmërinë e ligjit për rishikimin e Kushtetutës, në aspektin procedural, mund të paraqiten brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.

3. Gjykatat mund ta paraqesin kërkesën në çdo kohë, kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore konkrete, sipas nenit 145, pika 2, të Kushtetutës, çmojnë antikushtetutshmërinë e ligjit ose të aktit normativ.

4. Individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit.

Neni 51

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashikuara nga nenet 49 e 50 të këtij ligji, Gjykata Kushtetuese vlerëson:

- a) përmbajtjen e ligjeve dhe të akteve normative;
- b) formën e ligjeve dhe të akteve normative;
- c) procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të tyre.

2. Kur një ligj ose akt normativ ose pjesë të tij, që janë objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, shfuqizohen ose ndryshohen para se Gjykata Kushtetuese të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror.

Neni 51/a

Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të çështjes vendos:

- a) rrëzimin e kërkesës;
- b) pranimin tërësisht ose pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ.

2. Në çdo rast Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit shprehet edhe për efektin e vendimit dhe pasojat e tij.

Procedura për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual

Neni 71

E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual

1. Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kritereve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji.
2. Objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, sipas nenit 49, pika 3, të këtij ligji.
3. Gjykata Kushtetuese shqyrton përfundimisht ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas nenit 140, pika 4, dhe 148/d, të Kushtetutës.

Neni 71/a

Kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual

1. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur:
 - a) kërkuar ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion;
 - b) kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit;
 - c) pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuar;
 - ç) shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.

C. Jurisprudencë e GJK me subjekt kërkuar "organizatat"

-organizatat në mbrojtje të të drejtave të njeriut sipas misionit apo veprimtarisë

- ✓ vendimi nr.15/2003
- ✓ vendimi nr.25/2003
- ✓ vendimi nr.16/2004
- ✓ vendimi nr.20/2006
- ✓ vendimi nr.9/2010
- ✓ vendimi nr.4/2011
- ✓ vendimi nr.43/2011
- ✓ vendimi nr.7/2013
- ✓ vendimi nr.43/2017

- organizatat/shoqata në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të anëtarësisë

- ✓ vendimi nr.40, datë 06.05.1999
- ✓ vendimi nr.12, datë 21.03.2000
- ✓ vendimi nr.9, datë 26.02.2007

- ✓ vendimi nr.11, datë 04.04.2007
- ✓ vendimi nr.35, datë 10.10.2007
- ✓ vendimi nr.41, datë 16.11.2007
- ✓ vendimi nr.9, datë 19.03.2008
- ✓ vendimi nr.16, datë 25.07.2008
- ✓ vendimi nr.17, datë 25.07.2008
- ✓ vendimi nr.12, datë 28.04.2009
- ✓ vendimi nr.20, datë 09.07.2009
- ✓ vendimi nr. 24, datë 24.07.2009
- ✓ vendimi nr.3, datë 05.02.2010
- ✓ vendimi nr. 4, datë 12.02.2010
- ✓ vendimi nr. 33, datë 24.06.2010
- ✓ vendimi nr.31, datë 18.06.2010
- ✓ vendimi nr.7, datë 27.11.2015
- ✓ vendimi nr.10, datë 29.02.2016
- ✓ vendimi nr.16, datë 27.07.2016
- ✓ vendimi nr.33, datë 08.06.2016
- ✓ vendim nr. 13 datë 24.01.2018 i i Mbledhjes së Gjyqtarëve
- ✓ vendim nr. 14 datë 24.01.2018 i i Mbledhjes së Gjyqtarëve
- ✓ vendim nr.28 datë 08.02.2018 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

